

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ARBEN ZEFI

01/10/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 08.01.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Zefi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 10.01.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Arben Zefi, kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyqësore e kryesuar nga znj. Firdes Shuli, z. Roland Ilia relator, znj. Etleda Çiftja anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.